



# Përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në

sigurimin, ruajtjen, kontrollin  
dhe monitorimin e cilësisë së ujit








 AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

 ISP  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

 *Drejtoria e  
Përgjithshme  
e Ujësjellës  
Kanalizimeve*



# Përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në sigurimin, ruajtjen, kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujit




Korrik 2016



# Përmbajtja

Parathënie .....	5
Shkurtime .....	6
Përkufizime .....	7
Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) .....	11
Kompetencat e pushtetit lokal .....	14
Roli dhe përgjegjësitë e ujësjellësit .....	15
Roli dhe funksionet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm .....	23
Roli i Institutit të Shëndetit Publik për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm .....	27
Roli dhe përgjegjësitë e Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (Drejtoritë e Shëndetit Publik) për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm .....	31
Sektori i Higjienës Publike në Drejtoritë e Shëndetit Publik .....	37






## Parathënie

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) është në fazën e implementimit të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Ndërkohë, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të mekanizmave për ofrimin e një shërbimi cilësor për qytetarët. Shërbimi cilësor nënkupton jo vetëm furnizimin e vazhdueshëm me ujë, por mbi të gjitha me një ujë cilësisht të pastër. Në këtë kuadër, si dhe duke patur parasysh se garantimi i cilësisë së ujit, kërkon përfshirjen e disa aktorëve, MTI vlerësoi nevojën që aktorët të jenë të qartë për detyrimet dhe kompetencat që kanë, në mënyrë që ushtrimi sa më me efikasitet i këtyre detyrave, të sigurojë qëllimin parësor dhe final të të gjithë reformës: ofrimin e furnizimit me ujë cilësor dhe të pastër, si dhe të vazhdueshëm për qytetarët.

Ky dokument synon të rrisë ndërgjegjësimin e aktorëve, duke forcuar përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë që prej prodhuesve të ujit, të shoqërive të Ujësjellës-kanalizimeve (UK), e deri tek organet monitoruese të tilla si: Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, strukturat rajonale të Shëndetit Publik dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Ky dokument do të shërbejë edhe si një hap drejt forcimit të mekanizmave koordinues midis palëve të përfshira në këtë proces kompleks, por jetik për qytetarët, të cilët do të duhet të ndërgjegjësohen për rolin proaktiv që kanë dhe që duhet të ushtrojnë, për të mundësuar ruajtjen e burimeve dhe lehtësimin e ofrimit të ujit cilësisht të pastër.

Hartimi i këtij dokumenti u realizua nga Qendra e Shëndetit dhe Mirëqenies Komunitare (QSHMK) dhe u mbështet financiarisht nga Agjencia Austriake për Zhvillim në Shqipëri.





## Shkurtime

**AKUK:** Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve

**AUB:** Agjencia e Ujit të Basenit

**DSHP:** Drejtoria e Shëndetit Publik

**ERRU:** Enti Rregullator i Ujësjiellësit

**ISHP:** Instituti i Shëndetit Publik

**ISHSH:** Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

**ITUN:** Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

**KKU:** Këshilli Kombëtar i Ujit

**MSH:** Ministria e Shëndetësisë

**UK:** Ujësjiellës-Kanalizime

**VTUP:** Vepër e Trajtimit të Ujit të Pijshëm





## Përkufizime

- **Rezerva ujore** janë të gjitha burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë.
- **Përdorues** quhet çdo rreth, bashki, fshat, komunë, shoqatë e përdoruesve të ujit, ndërmarrje shtetërore apo private, person fizik dhe juridik që merret me eksplorimin, prodhimin, përdorimin e rezervave ujore dhe shkarkon ujëra të tepërta të përdorura ose substanca të tjera.
- **Autoriteti i ujit** është Këshilli i Basenit, autoriteti i të cilit ushtrohet brenda kufijve të një baseni.
- **Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU)** është organi qendror vendimor për administrimin e rezervave ujore.
- **Spektori i furnizimit me ujë** ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë që lidhen me grumbullimin, trajtimin dhe shpërndarjen e burimeve ujore për qëllime publike.
- **Prodhimi i ujit** ka të bëjë me të gjitha burimet natyrore të ujit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuaferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.
- **Grumbullimi i ujit** ka të bëjë me të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet strukturave apo mekanizmave të tilla si diga, puse, depo uji, cisterna, kanale, ujësjellësa, tubacione, kanale kulluese dhe kanalizime të ujërave të zeza, grumbullojnë, kanalizojnë, ndryshojnë drejtimin apo nxjerrin ujin për përfitim publik.

- **Shpërndarja e ujit** ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë me anë të të cilave uji pompohet, transportohet dhe shpërndahet nga një vend në tjetrin për përfitim publik.

- **Operatorët** janë subjektet e licencuara që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre.

- **Ujë i pastër:** Ujë i pijshëm nga sistemi publik i ujësjellësit i përcaktuar sipas standardeve në fuqi.

- **Ujë i pijshëm** është uji i përcaktuar për përdorim nga njerëzit, ku futen:

- a. ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për t'u pirë, për gatim, për përgatitje të ushqimeve dhe për nevoja të higjienës, pavarësisht origjinës së tyre dhe nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës publik apo privat, prej depozitave, prej autobotëve, prej puseve individuale apo kolektive, apo të ambalazuara në shishe ose në enë;

- b. ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve apo lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, si dhe ujërat për pastrimin e sipërfaqeve, objekteve apo materialeve që mund të jenë në kontakt me artikujt ushqimorë;

- c. akujt ushqimorë me origjinë ujore;

- d. ujërat e furnizuara për përdorim nga njerëzit, si pjesë e një aktiviteti tregtar apo publik, pavarësisht nga sasia mesatare e ujit të furnizuar në ditë.

- **Ujëmatësit** janë pajisje matëse të instaluar për të përcaktuar sasinë e ujit të konsumuar.

- **Konsumatori** është subjekti kontraktues i ujësjellësit që do të furnizohet me ujë (entet publike, privatët e konsumatorët familjarë).

- **Burimet ujore** janë të gjitha ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike cilësisht të përdorshme.



- **Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore** është njësi e qeverisjes vendore në territorin e së cilës kryhet veprimtaria lidhur me ujërat.
- **Administratori dhe/ose administratorët** është personi/subjekti (vendës apo i huaj), autoriteti publik ose institucioni privat që është përgjegjës për furnizimin, ose për pjesën e tij ose për çdo aktivitet tjetër që lidhet me furnizimin me ujë të pijshëm.
  - **Ujësjellësi** është sistemi i ndërtuar për prodhimin, depozitimin, transportimin, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm me cilësinë e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, deri në pikën e lidhjes së përdoruesve.
  - **Rezervuari** është objekt i ndërtuar mundësisht në pikën më të lartë të sistemit, që ka për qëllim depozitimin e sasisë së ujit që do të përdoret në orët e pikut (konsumit maksimal) dhe sigurimin e presionit të duhur në rrjetin e shpërndarjes.
  - **Autoboti** është rezervuar i lëvizshëm që përdoret në raste emergjence ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme.
  - **Vepër e trajtimit të ujit të pijshëm (VTUP)** janë proceset për trajtimin pastrues të ujit, të vendosura përpara rrjetit të shpërndarjes dhe/ose rezervuarit. Vepra duhet të përmbajë njësi të tjera përveç dezinfektimit.
    - **Lënda** është çdo produkt (lëndë apo përbërës) që shtohet në ujë ose përdoret për përmirësimin apo trajtimin pastrues të ujit, si dhe ato të përdorura për pastrimin e sipërfaqeve, pajisjeve, depozitave apo enëve që janë në kontakt me ujin e pijshëm.
    - **Autoriteti shëndetësor:** Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), strukturat rajonale të shëndetit publik (sipas përcaktimit në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin Publik”), Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH).
    - **Administratori** dhe/ose administratorët është personi/subjekti (vendës apo i huaj), autoriteti publik ose institucioni privat që është përgjegjës për furnizimin, ose për pjesë të tij ose për çdo aktivitet tjetër që lidhet me furnizimin me ujë të pijshëm.

- **Rrjeti i jashtëm i shpërndarjes** është sistemi i tubacioneve i projektuar për shpërndarjen e ujit të pijshëm nga vepra e trajtimit të ujit, ose rezervuari tek ujëmatësi i përdoruesit.

- **Rrjeti i brendshëm i shpërndarjes** përfshin tubacionet, nyjat dhe aparaturat e instaluara midis rubinetave, që përdoren normalisht për furnizimin me ujë të pijshëm, dhe rrjetit të jashtëm të shpërndarjes. Kufiri ndërmjet rrjetit të brendshëm të shpërndarjes dhe rrjetit të jashtëm të shpërndarjes, zakonisht i quajtur pika e ofrimit, përfaqësohet nga ujëmatësi, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën e shpërndarjes dhe furnizimit.



# Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve (AKUK)



## Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK)

AKUK është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ajo mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale, si dhe politikat përkatëse për administrimin e ujërave dhe mbrojtjen mjedisore të cilësisë së ujërave.

## Përgjegjësitë dhe detyrat e AKUK-ut

- AKUK, nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror dhe vendor.

- Mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

- Mund t'i propozojë ministrisë së linjës ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, dhe është pjesë e grupeve

të punës për hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare për sektorin.

- I propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, planifikimin e nevojave për investime, për ndërtimin/rehabilitimin e sistemeve të ujësjellësve, rrjeteve të kanalizimeve, impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanin kombëtar sektorial.

- Kontrollon dhe miraton nga pikëpamja teknike të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë UK apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit; ndjek zbatimin e projekteve me financim të huaj në këtë fushë, si dhe atë të kontratave të lidhura, duke qenë përgjegjëse edhe për monitorimin e ecurisë së tyre.

- Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

- Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

- Ka të drejtë të ushtrojë kontrolle me karakter teknik në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, dhe dorëzon të dhënat për përdorimin e ujit në Kadastrën Kombëtare të Ujit, pranë ministrisë përgjegjëse.

- Planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën për realizimin e trajnimeve të certifikimit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë dhe ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Përgatit projekte zhvillimore dhe projekte pilot me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera qendrore.

## Kompetencat e pushtetit lokal

Është në kompetencë të qeverisjes vendore:

1. Sigurimi që uji, i furnizuar nëpërmjet çdo rrjeti shpërndarës, depozite apo rezervuari fiks apo të lëvizshëm, pusi kolektiv, brenda zonës së tij territoriale, është i përshtatshëm për përdorim në pikën e ofrimit të tij të përdoruesi, sipas kërkesave të parashikuara.
2. Parashikimi i masave për sigurimin e furnizimit në rast emergjence me ujë të pijshëm, që plotëson kërkesat për sasinë dhe periudhën minimale të nevojshme për të përballuar nevojat lokale.
3. Përshtatja e planeve të ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në bashkëpunim me Agjencinë e Ujit të Basenit (AUB).

# Roli dhe përgjegjësitë e ujësjellësit



## Roli dhe përgjegjësitë e ujësjellësit

Administruesit e sistemit të ujësjellësit, qofshin këto ndërmarrje të shërbimit publik apo private, janë të detyruar t'i sigurojnë konsumatorit ujë higjienikisht të pastër në çdo kohë sipas normave të konsumit, me presione optimale në çdo pikë të rrjetit shpërndarës.

Misioni i ujësjellësit në zonën e shërbimit për ujin e pijshëm është:

- Menaxhimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për sigurinë e cilësisë së ujit në nivel rajonal.
- Sigurimi i një furnizimi me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi.
- Zbatimi i kuadrit ligjor për performancën, mbrojtja dhe ruajtja e aseteve të sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura e të impiantit të trajtimit të tyre.
- Garantimi në përgjithësi i një sistemi teknikisht të përshtatshëm të furnizimit me ujë, përfshirë dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

## Detyrat dhe përgjegjësitë e ujësjellësit

- Ujësjellësi realizon mbrojtjen higjieno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri te përdoruesi, sipas standardit kombëtar të ujit të pijshëm; VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 dhe



rekomandimeve për cilësinë e ujit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

- Ujësjellësi është përgjegjës për ndërtimin e rrjetit shpërndarës dhe të tubacioneve të lidhjes së banesave në pronë private, me qëllim që të respektohen standardet e kërkuara të ndërtimit. Megjithatë, ndërtimi i tyre mund të bëhet nga palë të treta, por punimet do të mbikëqyren detyrimisht nga ujësjellësi.

- Ujësjellësi siguron mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

- Rrjeti lidhës ndërtohet, rehabilitohet, rinovohet dhe modifikohet, mirëmbahet apo çmontohet vetëm nga ujësjellësi.

- Ujësjellësi siguron furnizimin me ujë nëpërmjet pikave të lidhjes. Pika e lidhjes së furnizimit me ujë të pronave të përdoruesve quhet pika e përcaktuar nga ujësjellësi në magjistralet e rrjetit shpërndarës, për të realizuar lidhjen e furnizimit me ujë të subjektit me rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm. Shërbimi me pikë-lidhje do të quhet vendosja nga ana e ujësjellësit e të gjithë elementeve që realizojnë skemën e furnizimit me ujë të objektit.

- Ujësjellësi merr masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit në sistemin e vet të furnizimit me ujë.

- Ndërmarrja administruese e ujësjellësit në bashkëpunim me strukturën rajonale të shëndetit publik, bën vendosjen e pikave të kontrollit të ujit që do të monitorohen në nivel rajonal. Tirana bën përjashtim pasi vendosja e pikave të kontrollit bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik, me ISHP-në, me Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë.

- Ujësjellësi për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm kryen analiza ditore në pika të caktuara në rrjetin shpërndarës dhe analiza periodike në burime, sipas një marrëveshjeje me Drejtorinë e Shëndetit Publik të Rrethit.

- Treguesit që ekzaminohen në ujin e pijshëm duhet të jenë në përputhje me VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 *Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm"*, i cili është njëherësh dhe standardi shqiptar i treguesve fiziko-kimik të ujit të pijshëm.

- Ujësjiellësi bën dezinfektimin (klorinimin) e ujit të pijshëm sipas VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 *Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm"*.

- Ujësjiellësi bashkëpunon me autoritetet shëndetësore rajonale dhe organet e qeverisjes vendore për menaxhimin e rasteve të ndotjeve, kur nuk lejohet konsumi i ujit të rrjetit, deri në përmirësimin e gjendjes.

- Administratori njofton strukturën rajonale të shëndetit publik për rastet e punimeve dhe defekteve në kaptazh, në linjat e jashtme, rezervuarët, në linjat kryesore, si dhe në rastet e rikonstruksioneve në këto objekte për verifikimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Ujësjiellësi siguron prodhimin dhe/ose blerjen e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.

- Ujësjiellësi ka fuqinë të ndalojë, të mbyllë dhe të parandalojë furnizimin me ujë të pijshëm të çdo lidhje konsumatori, nëse vërehen se janë shkelur dispozitat e rregullores, gjë që mund të sjellë dëmtimin, bllokimin e sistemit të ujësjiellësit ose cënimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Administratori bën vazhdimisht informimin e konsumatorit, sidomos kur ka shmangie.

- Ujësjiellësi bën menaxhimin në raste përmbytjesh dhe katastrofash natyrore, si dhe në kushte meteorologjike ose gjeografike të jashtëzakonshme; bashkëpunon me shërbimin e hidrogjeologjisë, organet e qeverisjes vendore, prefekturën, autoritetet shëndetësore, etj.

- Asnjë person ose subjekt nuk duhet të kryejë asnjë lloj punimi në sistemin e furnizimit me ujë, përveç ujësjiellësit.

- Ndërhyrje në rrjetin e ujësjiellësit konsiderohet, rasti kur përdoruesi i ujit të pijshëm bën një shtesë në linjat e furnizimit që sjell harxhim të ujit ose cënim të cilësisë së ujit, pa marrë më parë aprovim nga ujësjiellësi.

- Administratori është i detyruar të ruajë zonat e mbrojtjes sanitare dhe ndërhyr në çdo rast kur konstaton shkelje brenda territorit të tyre. Ai informon organet e qeverisjes vendore, që sipas rastit kërkojnë edhe ndihmën e organeve të ruajtjes së rendit. Njëkohësisht informon edhe strukturën rajonale të shëndetit publik.

- Veprat e marrjes së ujit (dhoma, galeri, tunele etj.) mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike nga administratori. Algat ose bimët e tjera ujore që rriten në këto objekte hiqen dhe më pas sipërfaqet dezinfektohen me solucion hipokloriti.

- Administratori kontrollon vazhdimisht rrjetin shpërndarës të ujës-jellësit për gjetjen dhe eliminimin e defekteve. Ai merr në konsideratë të gjitha njoftimet për defekte të zbuluara nga qytetarët apo organet e qeverisjes vendore. Defektet regjistrohen në një regjistër të veçantë ku vendosen elementet identifikuese të defektit: adresa e plotë, koha e konstatimit/njoftimit, kush njofton, kur është eliminuar defekti dhe kush i ka kryer punimet. Eliminimi i defekteve bëhet menjëherë sapo ai konstatohet/merret njoftimi.

- Administratori merr masa që asnjë lëndë apo material i përdorur për instalime që shërbejnë për përgatitjen apo shpërndarjen e ujit të pijshëm, si dhe asnjë papastërti që lidhet me këto lëndë apo materiale të mos kalojnë në ujin e pijshëm; lëndë që ndotin apo përkeqësojnë cilësinë e ujit dhe nënkuptojnë mosrespektim të kërkesave të standardeve të parametrave, ose një rrezik për shëndetin e popullatës së furnizuar.

- Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të rregullores së ujit të pijshëm. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cënuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t'i kërkojë autoritetit shëndetësor përgjashtimin nga dezinfektantët mbetës.

- Pas miratimit të çdo projektideje të një ujëmbledhësi të ri, tubacioneve, vepre trajtimi uji, rrjeti të furnizimit ose të shpërndarjes, rezervuari të rrjetit të shpërndarjes ose rimodelimi të instalimeve në përdorim, administratori njofton ISHSH-në, e cila kryen procedurën për lëshimin e aktmiratimit higjieno-sanitar.

## Monitorimi i brendshëm ka për qëllim verifikimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe është nën përgjegjësinë e administratorit.

a. Administratori i secilës pjesë të sistemit të furnizimit me ujë, kryen monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm që furnizon. Pikat e marrjes së kampionëve për monitorim duhet të jenë përfaqësuese të ujësjellësit ose pjesëve të tij, dhe përcaktohen nga struktura rajonale e shëndetit publik në bashkëpunim me administratorin. Ato bëhen të detyrueshme të respektohen me nënshkrimin e aktmarrëveshjes mes tyre. Struktura rajonale e shëndetit publik vë në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë një kopje të aktmarrëveshjes, dhe njofton çdo ndryshim të pikave të monitorimit brenda 30 ditëve nga ndryshimi i bërë.

b. Rezultatet e analizave të kryera dërgohen çdo muaj në strukturën rajonale të shëndetit publik, sipas formatit të raportimit të përcaktuar në aktmarrëveshje.

- Për kryerjen e analizave, administratori përdor laboratorin e brendshëm mikrobiologjik/biokimik ose lidh kontratë me një laborator të jashtëm mikrobiologjik/biokimik, të licencuar dhe që plotëson kërkesat e rregullores. Të paktën 2 vite pas monitorimit të brendshëm dhe në rast të parametrave të monitorimit verifikues, administratori mund t'i paraqesë kërkesën strukturës rajonale të shëndetit publik për të ulur

deri në 50% shpeshhtësinë e analizave të treguara në këtë rregullore për parametra të caktuara, nëse është i sigurt për pamundësinë e ndodhjes së atyre parametrave në ujin e pijshëm në një përqendrim të tillë që paraqet rrezik të mospërputhjes me vlerën e parametrave.

- Rezultatet e monitorimit që kryhet nga administratori, regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të strukturës rajonale të shëndetit publik dhe ISHSH-së rajonale, kur kërkohen prej tyre.

- Në situatën e një rreziku të mundshëm për shëndetin publik, struktura rajonale e shëndetit publik i kërkon administratorit kryerjen e analizave shtesë me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik.

- Administratori është përgjegjës për mirëmbajtjen e veprës së ujës-jellësit. Ai respekton kërkesat sipas rregullores së ujit të pijshëm, si dhe kërkesat e akteve të tjera në fuqi.

- Nëse cilësia e ujit të pijshëm pëson ndryshime që e bëjnë ujin të papërshtatshëm për përdorim, qoftë përkohësisht apo përgjithnjë, administratori informon popullatën dhe/ose administratorë të tjerë të interesuar, organet e qeverisjes vendore, strukturën rajonale të shëndetit publik, si dhe ERRU-në mbi ndodhinë e mospërputhjes, veprimet korrigjuese dhe masat parandaluese të parashikuara, nëpërmjet burimeve dhe në formën e përcaktuar në marrëveshje me strukturën rajonale të shëndetit publik, me qëllim shmangien e ndonjë rreziku që cënon shëndetin.

- Numri më i vogël i kampionëve të ujit për monitorim të brendshëm duhet të sigurojë përfaqësimin sa më domethënës të ujës-jellësit ose pjesëve të tij dhe të industrisë ushqimore, dhe duhet të jenë të shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë gjithë vitit.

- Shpeshhtësia më e vogël e marrjes së kampionëve për kontrollin rutinë dhe kontrollin verifikues përcaktohet në rregulloren e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Administratori zbaton masat korrigjuese të nevojshme për arritjen e cilësisë së duhur të ujit të furnizuar. Pas zbatimit të masave korrigjuese, administratori njofton strukturën rajonale të shëndetit

publik, e cila analizon një kampion të ri në pikën ku është evidentuar mospërputhja për të kontrolluar gjendjen e normalizimit.

### **Roli i administratorit në dezinfektimin e ujit të pijshëm**

- Administratori siguron kryerjen e dezinfektimit, si masë parandaluese për të evituar ndotjen e mundshme të ujit. Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e tij.

- Administratori siguron lëndët kimike sipas rregullores nëpërmjet subjekteve të licencuara për vendosjen në treg të këtyre lëndëve.

- Administratori është i detyruar që përpara se lëndët kimike të përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm, t'i dërgojë në strukturën rajonale të shëndetit publik për analiza kimike dhe të pajiset prej saj me miratimin për përdorimin e tyre.

- Dezinfektimi i ujit të pijshëm duhet të kryhet në të gjitha sistemet e furnizimit me ujë. Këtu duhet të sigurohet gjatë 24 orëve niveli i klorit i përcaktuar nga rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Para përdorimit të lëndëve dezinfektuese, përdoruesit bëjnë për çdo parti, kontrollin dhe analizat e nevojshme për përcaktimin e klorit aktiv. Për çdo parti të analizuar, administratori i ujësjellësit duhet të ketë në dispozicion rezultatet e analizave dhe miratimin e përdorimit nga struktura rajonale e shëndetit publik.

- Matja e nivelit të klorit të lirë në rrjetin e ujësjellësit bëhet nga administratori 2 herë në ditë në pikat e monitorimit, dhe çdo orë në dalje të rezervuarëve. Këto rezultate regjistrohen në regjistrin përkatës, duke shtuar edhe veçori të tjera, nëse ato vihen re gjatë matjes, si: turbullirë, ngjyrë etj.



Roli dhe funksionet e  
Inspektoratit Shtetëror  
Shëndetësor (ISHSH)  
në monitorimin e cilësisë  
së ujit të pijshëm



## Roli dhe funksionet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm

- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

- ISHSH-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik.

- Zbaton aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit shëndetësor, dhe siguron zbatimin e kontrollin e zbatimit të tyre nga strukturat inspektuese.

- ISHSH-ja kryen inspektimin në bashkëpunim të ngushtë me strukturat rajonale të shëndetit publik.

- Inspektimi i zbatimit të kërkesave ligjore të rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” kryhet nga ISHSH-ja, i cili, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, planifikon inspektimin bazuar në vlerësimin e rrezikut në raportet e monitorimit nga strukturat qendrore dhe rajonale të shëndetit publik, dhe sinjalizimet nga burime të tjera.

- Në rastet e mosrespektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, ISHSH-ja vepron sipas dispozitave të ligjit nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore në fuqi dhe



njofton Ministrinë e Shëndetësisë dhe AUB-në përkatëse.

- Ministri i Shëndetësisë përcakton metodikën dhe shpeshtësinë minimale të inspektimit nga ISHSH-ja.

- Çdo 6 muaj, ISHSH-ja raporton në Ministrinë e Shëndetësisë për veprimtarinë inspektuese.

- ISHSH-ja kryen procedurën për lëshimin e aktmiratimit higjieno-sanitar pas njoftimit nga administratori mbi miratimin e çdo projektideje të një ujëmbledhësi të ri, tubacioneve, veprave trajtimi uji, rrjeti të furnizimit ose të shpërndarjes, rezervuari të rrjetit të shpërndarjes ose rimodelimi të instalimeve në përdorim.

- ISHSH-ve rajonale kur lind nevoja u vihen në dispozicion rezultatet e monitorimit të ujit të pijshëm që bëhet nga administratori, i cili duhet t'i ruajë këto të dhëna për të paktën 5 vjet.

- ISHSH-ja ndalon përdorimin e ujit të pijshëm nga konsumatori, kur njoftohet nga strukturat rajonale të shëndetit publik mbi mosrespektimin e vlerave të parametrave për ujin e pijshëm në rrjetin e ujësjellësit, dhe u kërkon organeve të qeverisjes vendore dhe administratorit marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

- Indikatorë të ndryshëm (p.sh. amoni, klori i lirë, etj.) mbi vlerat e parametrave normale, por brenda një limiti të caktuar dhe pa cënuar shëndetin, lejohen vetëm me vendim të veçantë të ISHSH-së.





# Roli i Institutit të Shëndetit Publik për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm



## Roli i Institutit të Shëndetit Publik për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm

- Instituti i Shëndetit Publik shërben si qendër e sigurimit dhe kontrollit të cilësisë së laboratorëve të shëndetit publik, dhe si qendër reference laboratorike në monitorimin e ujit.
- Në raste ekspertizash të veçanta, rezultatet referencë të analizave të cilësisë së ujit të pijshëm janë ato të Institutit të Shëndetit Publik.
- Për parametra të caktuara, Instituti i Shëndetit Publik do të shqyrtojë metoda të tjera zyrtare të analizave, të ndryshme nga ato standarde, rezultatet e të cilave janë po aq të besueshme sa ato të përfutuara me metodat e përcaktuara si standarde.
- Strukturat rajonale të shëndetit publik dërgojnë hartën e pikave të kontrollit me emërtimet e tyre pranë ISHP-së dhe DSHP-së në MSH. Një kopje dërgohet pranë organeve të qeverisjes vendore.
- ISHP-ja ndjek në mënyrë të vazhdueshme dhe mban nën kontroll të vazhdueshëm situatën higjieno-sanitare të ujit të pijshëm në vend, nëpërmjet analizës së të dhënave periodike (15-ditore ose mujore) që vijnë nga strukturat rajonale të shëndetit publik, dhe bën vlerësimin e faktorëve të rrezikut në lidhje me monitorimin e ujit të pijshëm në nivel kombëtar.
- ISHP-ja përgatit në mënyrë periodike (mujore) Buletinin e Ujit të Pijshëm dhe e dërgon atë në institucionet qendrore dhe në të gjitha DSHP-të e rretheve.

- Bashkëpunimi në menaxhimin në raste përmytjesh dhe katastrofash natyrore, si dhe në kushte meteorologjike ose gjeografike të jashtëzakonshme. Bashkëpunimi me shërbimin e hidrogjeologjisë, organet e qeverisjes vendore, prefekturën, strukturat rajonale të shëndetit publik, Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror etj.

**Instituti i Shëndetit Publik informon konsumatorin;  
për këtë përgatit raportin vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të**



Roli dhe përgjegjësitë  
e Strukturave Rajonale  
të Shëndetit Publik  
(Drejtoritë e Shëndetit Publik)  
për sigurinë e cilësisë së  
ujit të pijshëm



## Roli dhe përgjegjësitë e Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (Drejtoritë e Shëndetit Publik) për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm

Strukturat rajonale të shëndetit publik janë përgjegjëse për bashkërendimin dhe zbatimin e veprimtarive në fushën e shëndetit publik, për promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe mbrojtjen e shëndetit nga ndikimet e dëmshme të mjedisit.

- Drejtoria e Shëndetit Publik përbën njësinë operative për sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm në nivel rajonal. Në këtë kuadër, ajo ka rol monitorues të të gjithë zinxhirit të furnizimit me ujë të pijshëm nga burimi i ujit (basene, rezervuare etj.) deri tek konsumatori (uji që vjen në çezmë).

- Monitorimi i jashtëm, (që përfshin kontrollin higjiëno-sanitar të objekteve të veprës së ujësjellësit, verifikimin e kryerjes së monitorimit të brendshëm dhe analizimin e rezultateve të këtij monitorimi, kontrollin e zonave të mbrojtjes sanitare, si dhe kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit) është nën përgjegjësinë e strukturës rajonale të shëndetit publik, për të siguruar që uji i pijshëm në territorin e vet administrativ plotëson kërkesat e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”.

- Për çdo monitorim, struktura rajonale e shëndetit publik harton raportin e monitorimit, dhe në rast të konstatimit të parregullsive jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. Struktura rajonale e shëndetit publik i dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-së rajonale.



- Strukturave rajonale të shëndetit publik kur lind nevoja u vihen në dispozicion rezultatet e monitorimit të ujit të pijshëm që bëhet nga administratori, i cili duhet t'i ruajë këto të dhëna për të paktën 5 vjet.

- Për kryerjen e analizave, struktura rajonale e shëndetit publik përdor laboratorin e brendshëm mikrobiologjik/biokimik ose lidh kontratë me një strukturë tjetër të shëndetit publik.

- Rezultatet referencë të analizave të cilësisë së ujit të pijshëm janë ato të laboratorëve kimiko-bakteriologjik të shërbimit të higjienës dhe epidemiologjisë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, dhe në raste ekspertizash të veçanta ato të Institutit të Shëndetit Publik. Rezultatet e këtij monitorimi regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-së rajonale, kur kërkohen prej tyre.

- Ministri i Shëndetësisë përcakton objektet dhe shpeshhtësinë minimale të kontrollit nga strukturat rajonale të shëndetit publik.

- Kur struktura rajonale e shëndetit publik gjykon se ka një rrezik për shëndetin publik, kërkon nga administratori të rrisë shpeshhtësinë e marrjes së kampionëve për ato parametra që struktura rajonale e shëndetit publik i vlerëson të nevojshme.

- Shpeshhtësia e marrjes së kampionëve për dezinfektantët mbetës mund të rritet nëse vlerësohet e nevojshme nga struktura rajonale e shëndetit publik.

- Shpeshhtësia e marrjes së kampionëve për ujin në depozita dhe autobotë, përcaktohet për çdo rast nga struktura rajonale e shëndetit publik.

- Nëse ndodh apo jo mospërputhje me vlerat e parametrave, sa herë që furnizimi me ujë të pijshëm përbën një rrezik potencial për shëndetin publik, struktura rajonale e shëndetit publik vendos kufizimin ose ndalimin e përdorimit të ujit të pijshëm ose marrjen e masave të tjera të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit. Struktura rajonale e shëndetit publik vendos, gjithashtu, për masat që duhen marrë duke pasur parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut që mund të shkaktohen nga ndërprerja e furnizimit ose përdorimi i kufizuar i ujit të pijshëm.

Struktura rajonale e shëndetit publik informon ISHSH-në, AUB-në dhe ERRU-në.

- Strukturat rajonale të shëndetit publik përgatisin raportin vjetor mbi cilësinë e ujit të pijshëm në rajonin e tyre.

- Në ushtrimin e rolit të saj, Drejtoria e Shëndetit Publik ndërvepron ngushtësisht me Institutin e Shëndetit Publik dhe Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila është edhe njësia operative për sigurinë e cilësisë së ujit në nivel kombëtar.

- Drejtoria e Shëndetit Publik bën menaxhimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për sigurinë e cilësisë së ujit në nivel rajonal.

- Drejtoria e Shëndetit Publik ka si detyrë kryesore monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm nga burimi deri në çezmat e konsumatorit.

- Drejtoria e Shëndetit Publik informon Institutin e Shëndetit Publik dhe Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare në nivel lokal, lidhur me sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Drejtoria e Shëndetit Publik bën raportimin periodik (15-ditor ose mujor) dhe informon Institutin e Shëndetit Publik dhe Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor pranë MSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm.

- Strukturat rajonale të shëndetit publik kanë rol të rëndësishëm në parandalimin e problemeve të shëndetit publik nga cënimi i cilësisë së ujit të pijshëm, në bashkëpunim me sektorët e tjerë të DSHP-së, si dhe me të gjitha strukturat e tjera si ujësjellësi, strukturat e qeverisjes vendore, ISHSH etj.

- Strukturat rajonale të shëndetit publik vendosin pikat e kontrollit të ujit që do të monitorohen në nivel rajonal, në bashkëpunim me ndërmarrjen administruese të ujësjellësit. (Tirana bën përjashtim pasi vendosja e pikave të kontrollit bëhet në bashkëpunim me ujësjellësin, me ISHP-në, dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë).

- Strukturat rajonale të shëndetit publik dërgojnë hartën e pikave të kontrollit me emërtimet e tyre pranë ISHP-së dhe Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor në MSH. Një kopje dërgohet pranë organeve të qeverisjes vendore.

- Strukturat rajonale të shëndetit publik bashkëpunojnë në

menaxhimin e rasteve të përmytjeve dhe katastrofave natyrore, si dhe në kushte meteorologjike ose gjeografike të jashtëzakonshme me shërbimin e hidrogjeologjisë, organet e qeverisjes vendore, prefekturën, ISHP-në, Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror etj.

- Strukturat rajonale të shëndetit publik duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e rregullt të sektorit të higjienës publike në takimet informuese dhe trajnimet e organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat partnere në fushën e sigurisë së cilësisë së ujit.





Sektori i  
Higjienës Publike në  
Drejtoritë e Shëndetit Publik



## Sektori i Higjienës Publike në Drejtorinë e Shëndetit Publik

### *Funksionet e Sektorit*

Funksionet e Sektorit të Higjienës Publike kanë të bëjnë me:

- Ushtrimin e rolit të tij duke ndërvepruar ngushtësisht me Drejtorinë e Shëndetit Publik, e cila është edhe njësi operative për sigurinë e cilësisë së ujit në nivel rajonal.

- Monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm nga burimi deri në çezmat e konsumatorit.

- Monitorimin e rregullave higjiëno-sanitare për projektimin, ndërtimin, rikonstruksionin dhe shfrytëzimin e veprave të furnizimit me ujë të pijshëm.

- Monitorimin e origjinës së ujërave që përdoren për konsum njerëzor, që mund të jenë:

a - ujëra nëntokësore (burime natyrore, pus çpime hidrogjeologjike, puse kolektive, ose individuale).

b - ujëra sipërfaqësore (ujëmbledhësa, lumenj, liqene).

- Monitorimin e mbrojtjes së zonave sanitare të burimeve të ujërave sipërfaqësore.

- Monitorimin e mbrojtjes së zonave sanitare të burimeve të ujërave nëntokësore.

- Monitorimin e funksionimit normal të të gjitha objekteve të ujësjellësit dhe të masave të marra nga administruesit ose pronarët e

tyre për të kontrolluar cilësinë e ujërave.

- Monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe përcaktimin e indikatorëve të ndotjes, nëpërmjet ekzaminimit në laboratorin e ujit (laboratori kimik dhe bakteriologjik).

- Monitorimin e nivelit të klorit të lirë në rrjetin e ujësjellësit.

- Njoftimin me shkrim të drejtorit të shëndetit publik, kur rezultatet e analizave të ujit nuk përputhen me normat e standardit tonë shtetëror.

- Në rastet kur vërehen ndryshime të cilësisë së ujit të pijshëm, rritet frekuenca e kontrollit të marrjes së mostrave dhe i pikave të kontrollit në rrjetin shpërndarës derisa të stabilizohet gjendja. Mbajtja në monitorim i zonës së prekur nga ndotja.

- Monitorimin e sigurisë së cilësisë së ujit të pijshëm të puseve kolektive ose private, sidomos në rastet kur janë e vetmja mundësi e furnizimit me ujë (mungon rrjeti i ujësjellësit). Qeverisja vendore është përgjegjëse për ndërtimin, mirëmbajtjen, respektimin e rregullave higjieno-sanitare, dezinfektimin dhe ruajtjen në çdo kohë të gjendjes së ujit të puseve kolektive, brenda kërkesave të cilësisë së ujit të pijshëm.

- Bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore dhe me qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonën ku ndodhen këto puse.

- Ofrimin e shërbimit/ndihmës pranë organeve të pushtetit vendor për sigurinë e cilësisë së ujit të puseve kolektive; dozat e nevojshme për dezinfektimin e ujit dhe metodikën e përgatitjes së solucionit dezinfektant.

- Analizimin në laboratorin kimik të ujit të lëndës dezinfektante (hipoklorit natriumi apo kalciumi).

- Grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të aktivitetit të vetë sektorit, në bashkëpunim me sektorët e tjerë brenda Drejtorisë së Shëndetit Publik, në lidhje me sigurinë e cilësisë së ujit të pijshëm.

- Vlerësimin e gjendjes dhe artikulumin e nevojave konkrete të sektorit lidhur me organizimin, funksionimin, strukturën e shërbimeve, infrastrukturën, ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale, etj.

- Përpilimin e raportimit periodik (ditor, javor, mujor, etj.) dhe informimin e shefit të shërbimit dhe drejtorit të shëndetit publik për cilësinë e ujit të pijshëm.

